



REPUBLIKA E SHQIPËRISË
KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

V E N D I M
K.P.P. 618/2017

Komisioni i Prokurimit Publik, i përbërë nga:

Evis Shurdha	Kryetar
Hektor Balluku	Anëtar
Kleves Janku	Anëtar

Në mbledhjen e datës 23.08.2017 shqyrtoi ankesën me:

Objekt:

Modifikimi i dokumentave të procedurës së prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt: “Shërbim me roje private SH.P.S.F 2017”, me nr. REF-19243-07-03-2017, me fond limit 3.486.139,49 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

Ankimues:

“Dea Security” sh.p.k.
Adresa: Rruga “Ndre Mjeda”, Qendra Polifunksionale, Kati I-rë, Tiranë.

Autoriteti Kontraktor:

Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”
Adresa: Bulevardi “Zogu i Parë”, Tiranë.

Baza Ligjore:

Ligji nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 19/1 e vijues, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 914, datë 29.12.2014 “Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, i ndryshuar, Vendimi i Këshillit të Ministrave nr. 184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar.

Komisioni i Prokurimit Publik, pasi dëgjoi relatorin e çështjes shqyrtoi parashtrimet me shkrim të ankimuesit, dokumentacionin e paraqitur nga autoriteti, pretendimet e ankimuesit, dhe pasi diskutoi çështjen në tërësi,

Vëren:

I

Vlerësimi paraprak

I.1. Pas shqyrtimit paraprak të ankesës të mbështetur në dokumentacionin e dërguar nga operatori ekonomik ankimues, Komisioni i Prokurimit Publik konstatoi se ky i fundit ka prima facie interes në këtë procedurë prokurimi dhe për këtë arsye legjitimohet për të paraqitur ankesë në lidhje me të, bazuar në pikën 1 të nenit 63 të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar;

I.2. Operatori ekonomik ka paraqitur fillimisht ankesë pranë autoritetit kontraktor, dhe më pas ka paraqitur ankesë, pranë Komisionit të Prokurimit Publik, si organi më i lartë në fushën e prokurimeve, që shqyrton ankesat për procedurat e prokurimit, në përputhje me kërkesat e përcaktuara në ligjin nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”;

I.3. Ka respektuar afatet ligjore të paraqitjes së ankesës pranë autoritetit kontraktor dhe Komisionit të Prokurimit Publik;

Në këto kushte Komisioni i Prokurimit Publik mori në shqyrtim në themel objektin e ankesës së operatorit ekonomik ankimues.

Public Health Sector

II

Rrethanat e çështjes

II.1. Në datën 04.07.2017 është publikuar në sistemin e prokurimeve elektronike, në faqen zyrtare të Agjencisë së Prokurimit Publik, procedura e prokurimit “Kërkesë për propozim”, me objekt: “Shërbim me roje private SH.P.S.F 2017”, me nr. REF-19243-07-03-2017, me fond limit 3.486.139,49 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.

II.2. Në datën 07.07.2017, operatori ekonomik ankimues “Dea Security” sh.p.k., ka paraqitur ankesë pranë autoritetit kontraktor, duke kundërshtuar kriteret e kualifikimit e konkretisht:

[...]

Së pari në dokumentat e tenderit “Specifikimet teknike” AK shprehet se “Objekti: Model Preventiv për – “Shërbimi me roje private SHPSF” dhe AK ka publikuar model preventivin por AK ka paraqitur një renditje të zërave të shpenzimeve të cilat krijojnë konfuzion në mënyrën e përlllogaritjes së ofertës.

A. - Fondi i pagave : Paga baze Punonjes Periudha e Preventivuar (muaj)

B. - Shtesat mbi page

Shtesat mbi page per turnin e II-te

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune mesatare ne muaj

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

Shtesat mbi page per turnin e III-te

Nr. i punonjesve Ore shtese

Ditepune mesatare ne muaj

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

Shtesat mbi page per ditet e Diela

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Dite pune te Diela

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

Shtesat mbi page per ditet e Festave Zyrtare

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune per Festa Zyrtare

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

C. - Shuma (A + B)

D. - Shpenzime per Sigurime Shoqerore, ne perqindje Perqindja e shteses

E. - Shuma (C + D)

F. - Shpenzime Plotesuese (Uniforma, etj.), ne perqindje Perqindja e shteses

G. - Shuma (E + F)

H. - Fitimi Perqindja Shuma - I (G + H)

Sa më sipër kjo mënyrë përcaktimi krijon konfuzion dhe paqartësi në mënyrën e përllogaritjes së ofertës. Referuar LPP, nenit 23 pika 1 dhe 4 [...]. Në lidhje me sa më sipër është shprehur edhe KPP nëpërmjet vendimit nr. 688/2015 dhe vendimit nr. 53/2017. Për sa më sipër AK në dokumentat e tenderit duhet të bëjë përcaktimin e saktë të elementëve të zërave në ofertë dhe të shmangë krijimin e konfuzionit të cilët mund të cojnë në përllogaritje të gabuar të ofertës.

Së dyti autoriteti ka përcaktuar numrin e rojeve:

- Vendroja me 3 (tre) turne (4.86 punonjës/vendroje).
- Vendroja me 3 (dy) turne (3.24 punonjës/vendroje).
- Vendroja me 3 (një) turne (1.08 punonjës/vendroje).



Ky numër është i pamjaftueshëm pasi referuar udhëzimit nr 308, datë 22.05.2017 për SHPSF Kreu III, germa A, pika b) përcakton se: Numrin e vendrojeve dhe numrin e punonjësve të shërbimit, duke llogaritur për 40 orë punë në javë ose koeficienti 1.66 për një punonjës shërbimi. Pra sipas përcaktimit ligjor:

- *Për vendrojen me tre turne numri i rojeve duhet të jetë: $1.66 \times 3 = 4.98$ roje.*
- *Për vendrojen me dy turne numri i rojeve duhet të jetë: $1.66 \times 2 = 3.32$ roje.*
- *Për vendrojen me një turn numri i rojeve duhet të jetë: 1.66 roje.*

Së treti, duke qenë se numri i rojeve sipas dispozitave të ligjit duhet të ndryshohet nga 14.04 roje në 14.94 roje atëherë duhet të ndryshohet edhe fondi limit i cili sipas numrit të ri të rojeve del i pamjaftueshëm për përmbushjen e shpenzimeve të detyrueshme ligjore.

Përfundimisht nga argumentimi i mësipërm kërkojmë nga ana e autoritetit tuaj modifikimin e kriterëve të kualifikimit të përcaktuara në DST, të cilat kufizojnë pjesëmarrjen në këtë procedurë prokurimi dhe bien në kundërshtim me përcaktimet ligjore.

II.3. Bazuar në informacionin e dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor pranë KPP, në datë 07.07.2017 autoriteti kontraktor i ka kthyer përgjigje operatorit ekonomik ankimues më shkresën nr. 745/1 Prot, me përmbajtje si më poshtë:

[...]

Ju bëjmë me dije se procedura objekt ankimi është pezulluar referuar pikës 1, të VKM – së nr 482, datë 05.07.2017 “Për pezullimin e përkohshëm të procedurave të prokurimit për vitin 2017”, si rrjedhojë nuk mund të marrim në shqyrtim ankesën e paraqitur nga ana juaj.

II.4. Në datën 17.07.2017 operatori ekonomik ankimues ka paraqitur ankesë në Komisionin e Prokurimit Publik, duke pretenduar modifikimin e dokumentave të procedurës së prokurimit objekt shqyrtimi.

II.5. Në datën 24.07.2017, është depozituar në Komisionin e Prokurimit Publik informacioni i autoritetit kontraktor lidhur me ankesën e operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k.

III

Komisioni i Prokurimit Publik

pas shqyrtimit të ankesës, dokumentacionit bashkëngjitur, dokumentave të dërguara nga autoriteti kontraktor,

Arsyeton

III.1. Lidhur me pretendimin e ankimuesit se “AK në dokumentat e tenderit duhet të bëjë përcaktimin e saktë të elementëve të zërave në ofertë dhe të shmangë krijimin e konfuzionit të cilët mund të cojnë në përlllogaritje të gabuar të ofertës”, Komisioni i Prokurimit Publik vëren se:

III.1.1. Në Njoftimin e kontratës, pika 2.2 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës” është parashikuar si më poshtë:

1. Lloji i procedurës së prokurimit: *Kërkesë për Propozim*
2. Objekti i kontratës/marrëveshje kuadër: *Shërbimi me roje private SH.P.S.F – 2017*
3. Fondi limit: *3.486.139,49 (tre milion e katerqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e njëqind e tridhjetë e nente leke e dyzet e nente qindarka) pa TVSH*
4. Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: *01.08.2017 – 31.12.2017*

III.1.2. Në shtojcën 11 “*Shërbimet dhe grafiku i ekzekutimit*”, të dokumentave standarte të tenderit, nga ana e autoritetit kontraktor është kërkuar:

Objekti : Model Preventivi për - "Shërbimi me roje private SH.P.S.F."

Vendrojet :

- 1 . *Dera kryesore 1 (nje) vendroje me 3 (tre) turne, TI+TII+TIII, 24 ore*
- 2 . *Dera Repartit Obstetrike 1 (nje) vendroje me 3 (tre) turne, TI+TII+TIII, 24 ore*
- 3 . *Dera Repartit Gjinekologji 1 (nje) vendroje me 2 (dy) turne, TI+TII, 16 ore*
- 4 . *Dera Administrates 1 (nje) vendroje me 1 (nje) turn, me orar 08.00 - 16.00, 8 ore, për të cilën (Ditët e Shtunde, Diele, Festa do të jenë Pushim)*

Per Vendrojet 1+2+3, turnet janë si më poshtë:

Turni i I-re, orari 06.00 - 14.00; Turni i II-te, orari 14.00 - 22.00; Turni i III-te, orari 22.00 - 06.00

Preventivi I-re - Vendroja me 3 (tre) turne (4,86 punonjes/vendroje)

A. - Fondi i pagave :

Paga baze

Punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

B. - Shtesat mbi page

Shtesat mbi page për turnin e II-te

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Dite pune mesatare në muaj

Paga mesatare orare për punonjes

Perqindja e shteses mbi page për punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

Shtesat mbi page për turnin e III-te

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Dite pune mesatare në muaj

Paga mesatare orare për punonjes

Perqindja e shteses mbi page për punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

Shtesat mbi page për ditët e Diela

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Dite pune të Diela

Paga mesatare orare për punonjes



Perqindja e shteses mbi page per punonjes
Shtesat mbi page per ditet e Festave Zyrtare

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Dite pune per Festa Zyrtare

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

C. - Shuma (A + B)

D. - Shpenzime per Sigurime Shoqerore, ne perqindje

Perqindja e shteses

E. - Shuma (C + D)

F. - Shpenzime Plotesuese (Uniforma, etj.), ne perqindje

Perqindja e shteses

G. - Shuma (E + F)

H. - Fitimi

Perqindja

Shuma - I (G + H)

II Preventivi II-te - Vendroja me 3 (tre) turne (4,86 punonjes/vendroje)

A. - Fondi i pagave :

Paga baze

Punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

B. - Shtesat mbi page

Shtesat mbi page per turnin e II-te

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune mesatare ne muaj

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

Shtesat mbi page per turnin e III-te

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune mesatare ne muaj

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

Shtesat mbi page per ditet e Diela

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune te Diela

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes



Shtesat mbi page per ditet e Festave Zyrtare

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune per Festa Zyrtare

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

C. - Shuma (A + B)

D. - Shpenzime per Sigurime Shoqerore, ne perqindje

Perqindja e shteses

E. - Shuma (C + D)

F. - Shpenzime Plotesuese (Uniforma, etj.), ne perqindje

Perqindja e shteses

G. - Shuma (E + F)

H. - Fitimi

Perqindja

Shuma - II (G + H)

III Preventivi III-te - Vendroja me 2 (tre) turne (3.24 punonjes/vendroje)

A. - Fondi i pagave :

Paga baze

Punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

B. - Shtesat mbi page

Shtesat mbi page per turnin e II-te

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune mesatare ne muaj

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

Shtesat mbi page per ditet e Diela

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune te Diela

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

Shtesat mbi page per ditet e Festave Zyrtare

Nr. i punonjesve

Ore shtese

Ditepune per Festa Zyrtare

Paga mesatare orare per punonjes

Perqindja e shteses mbi page per punonjes

C. - Shuma (A + B)

D. - Shpenzime per Sigurime Shoqerore, ne perqindje



Perqindja e shteses

E. - Shuma (C + D)

F. - Shpenzime Plotesuere (Uniforma, etj.), ne perqindje

Perqindja e shteses

G. - Shuma (E + F)

H. - Fitimi

Perqindja

Shuma - III (G + H)

IV Preventivi IV-te - Vendroja me 1 (nje) turn (1.08 punonjes/vendroje)

A. - Fondi i pagave :

Paga baze

Punonjes

Periudha e Preventivuar (muaj)

B. - Shtesat mbi page

C. - Shuma (A + B)

D. - Shpenzime per Sigurime Shoqerore, ne perqindje

Perqindja e shteses

E. - Shuma (C + D)

F. - Shpenzime Plotesuere (Uniforma, etj.), ne perqindje

Perqindja e shteses

G. - Shuma (E + F)

H. - Fitimi

Perqindja

Shuma - IV (G + H)

Shuma Totale (I + II + III + IV)

T.V.SH. 20 %

Shuma Totale (I + II + III + IV), me T.V.SH.

Shuma totale per 1 (nje) muaj, pa TVSH

Shuma totale per 1 (nje) muaj, me TVSH



III.1.3. Në ligjin nr.9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, neni 23, pika 1 dhe 4, përcaktohet se: “*Specifikimet teknike, që përcaktojnë karakteristikat e mallrave, punëve dhe shërbimeve që do të prokurohen, duhet të përgatiten për të përshkruar sa më saktë dhe në mënyrë të plotë objektin e prokurimit, duke krijuar kushte për konkurrim të paanshëm e të hapur ndërmjet të gjithë kandidatëve e ofertuesve. Kur është e mundur, specifikimet teknike duhet të përcaktohen në mënyrë të tillë që të kuptohen nga personat me aftësi të kufizuara.*

Përshkrimi i punimeve, mallrave apo shërbimeve duhet të përmbajë specifikimet teknike, që duhet të plotësohen në rast nevojë, edhe plane, vizatime, modele, makete etj. Në rast të përshkrimit funksional të punimeve apo të mallit, specifikimet teknike duhet të përshkruajnë në mënyrë të saktë dhe neutrale qëllimin e punimeve për njohjen e të gjitha kushteve dhe rrethanave me rëndësi për hartimin e ofertës. Nga përshkrimi i punimeve apo mallrave duhet të dalë jo vetëm qëllimi i punës së kryer, por edhe kërkesat që kanë lidhje me këtë punim nga pikëpamja teknike, ekonomike, estetike dhe funksionale. Që të garantohet krahasueshmëria e ofertave për kërkesat e objektit të

kontratës, për këto punime ose për funksionin e tyre, kërkesat e rendimentit dhe të funksionit duhet të jenë të sakta për t'u dhënë konkurruesve dhe ofertuesve një ide të qartë në përgatitjen e ofertës. Në përshkrimin e punimeve duhet të shënohen, kur është rasti, edhe specifikimet për furnizimin e mallrave apo të shërbimeve, të përshtatshme për mjedisin.”

III.1.4. Në Vendimin e Këshillit të Ministrave nr. 1, datë 10.01.2007 “Për rregullat e prokurimit publik”, i ndryshuar, Kreu III, pika 3/c përcaktohet

“Natyra e shërbimeve duhet të shprehet qartë në termat e referencës, ku përfshihen objekti, qëllimi, specifikimet teknike dhe afatet kohore të shërbimit, që do kryhet dhe gjithë elementët e tjerë të nevojshëm”.

III.1.5. Komisioni i Prokurimit Publik me anë rekomandimit të përbashkët me Agjencinë e Prokurimit Publik nr. 2511 prot. dhe nr. 180 prot, datë 06.02.2017 me objekt: *“Rekomandim mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i cili është publikuar në faqen zyrtare të KPP (www.kpp.gov.al) dhe që i shtrin efektet e tij për të gjitha procedurat e prokurimit të shpallura pas datës 13.02.2017; ju është drejtuar autoriteteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë si më poshtë vijon:*

“Agjencia e Prokurimit Publik (APP) dhe Komisioni i Prokurimit Publik (KPP) në lidhje me procedurën e prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike, me qëllim:

shmangien sa më shumë të jete e mundur të vonësve në realizimin e kësaj procedure; reduktimin e numrit të ankesave;

shmangien e gabimeve në përlogaritje të fondit limit dhe/ose të kërkesave të tjera, të cilat çojnë në anulimin e procedurës;

shmangien e situatave “emergjente” në të cilat autoritetet kontraktore janë të pambuluara me këto lloje shërbimi, dhe si të tilla çojnë në përdorimin e procedurës me negociim pa shpallje paraprake të njoftimit të kontratës,

bashkerishtë vendosen të hartojnë një material orientues, i cili iu drejtohet të gjitha autoriteteve kontraktore që përdorin këto lloje procedure, si dhe të gjithë operatorëve ekonomikë që marrin pjesë në këto procedure, me përmbajtje si vijon:

Bazuar në nenin 18, pika g, të Ligjit nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, i cili përcakton se: “Paga e punonjesit të rolit baze të shërbimit të jete minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave”, si dhe në Vendimin e Këshillit të Ministrave (VKM) nr. 573, datë 03.07.2013 “Për përcaktimin e pages minimale në shkallë vendi”, e cila përcakton se:

“Paga baze minimale, mujore, për punonjesit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jete 22.000 (nëzet e dy mijë) leke. Paga baze minimale, mujore, jepet për 174 ore punë në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga baze minimale orare të jete 127 (nëqind e njëzet e shtatë) Zeke”, sqarojmë se, paga minimale

mujore e punonjesve te sherbimit privat te sigurise fizike eshte 33.000 (tridhjetë e tre mijë) leke dhe jepet per 174 (nëqind e shtatëdhjetë e katër) ore pune ne muaj.

Ne kete kontekst, rekomandojme qe llogaritjet te kryhen bazuar ne pagen orare 189,65 leke.

2. APP dhe KPP rekomandon qe shtesat e turneve te dyta dhe te treta te perlllogariten duke u bazuar ne piken 1 te ketij rekomandimi, por duhet te mbahet ne konsiderate edhe periudha kohore, sipas shtrirjes se sherbimit per periudhen e mbetur gjate nje viti buxhetor.

Shembull: Per sherbimin qe do te kryhet me kohezgjatje 12 muaj, rekomandojme qe shtesat te perlllogariten per periudhen kohore 30.41 dite ne muaj.

Sipas ketij shembulli, keto shtesa do te perlllogariten ne perputhje me kohezgjatjen e sherbimit sipas nevojave perkatese.

Ndersa, nese sherbimi do te kerkohet te kryhet nga dita e hena ne te premte, rekomandojme qe shtesat te perlllogariten per periudhen kohore 21.75 dite ne muaj.

Gjithashtu, ne kete ze shpenzimesh, rekomandojme te merren ne konsiderate edhe parashikimet e Kodit te Punes, sa i takon shtesave mbi page.

Konkretisht, sipas parashikimeve te neni 81 i tij, cdo ore pune e kryer nga ora 19.00 deri ne 22.00, jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 20% dhe, cdo ore pune e kryer midis intervalit nga ora 22.00 deri ne 6.00, jep te drejten e nje shtese mbi page jo me pak se 50%.

Ne pergatitjen e ofertave ekonomike, ne varesi edhe te numrit te rojeve per nje vendroje, rekomandojme qe ofertuesit t'i referohen edhe parashikimeve te nenit 87 te Kodit te Punes, I cili percakton se, puna e kryer dite e pushimit javor, ose ne ditet e festave zyrtare kompesohet me nje shtese page jo me pak se 25 per qind, ose me nje pushim te barabarte me kohezgjatjen e punes se kryer plus nje pushim shtese jo me pak se 25 per qind te kohezgjatjes se kesaj pune, qe merret nje jave para ose pas kryerjes se saj.

3. Kontributi i detyrueshern per sigurimet shoqerore e shendetesore i te punesuarit, qe paguhet nga punedhenesi, eshte 16.7%, referuar pikes III.3 te VKM nr. 1114, date 30.07.2008 "Per disa ceshtje ne zbatim te ligjeve nr.7703, date 11.05.1993 "Per sigurimet shoqerore ne RSH".

4. Duke marre shkas, nga ndryshimet e fundit te legjislacionit sektorial per sherbimin privat te sigurise fizike (Ligji nr.75/2014), si edhe Ligjit per Armet (Ligji 74/2014), te cilet kane sjelle avantazhe ne organizimin e tregut te ofrimit te sherbimit privat te sigurise fizike, rekomandojme qe mos perlllogariten shpenzimet e armatimit, pasi referuar legjislacionit ne fuqi armet jane ne pronesi.

5. Rekomandojme qe, llogaritjet e zerave te shpenzimeve te mos kalojne dy shifra pas presjes dhjetore.

6. Autoritetet kontraktore duhet te percaktojne sakte numrin e vandrojeve dhe numrin e rojeve ne nje vandroje, duke marre ne konsiderate koeficientin e zevendesimit bazuar ne te drejttat e

punonjesve te sherbimit per leje te zakonshme, pushimet ne fundjave (shtune, djele), si dhe te drejten per pushim ne rast feste zyrtare, me qellim qe t'u krijohen lehtesi operatoreve ekonomike, sine pergatitjen e ofertes se tyre, por edhe me pas, ne realizimin e objektit te prokurimit dhe lehtesimin e punes se autoritetit kontraktor per verifikimin e zbatimit te kushteve te kontrates.

7. Duke qene se, periudha kohore nga data e lidhjes se kontrates deri ne perfundimin e objektit te prokurimit, ne shumicen e rasteve, nuk perkon me periudhen e parashikuar ne dokumentat e tenderit, lidhur me afatet e ekzekutimit te kontrates (per shkaqe te autoritetit kontraktor ose jashte kontrollit te tij), rekomandohen autoritetet kontraktore te kerkojne ne dokumentat e tenderit, qe operoret ekonomike te paraqesin oferta ekonomike bazuar ne koston mujore te kryerjes se sherbimit te ruajtjes me roje.

Rekomandojme qe ne kete rast, edhe vleresimi te behet bazuar vetem ne kete kosto mujore.

Kjo kerkese kushtezohet nga fakti i lehtesimit te punes se operatoreve ekonomike ne pergatitjen e ofertave, pasi eshte konstatuar qe operoret ekonomike ofertojne me periudha kohore te ndryshme, duke mos u vendosur ne kushte te barabarta.

Ne lidhje me hartimin e kriterit per paraqitjen e certifikatave te punonjesve te sherbimit, ne kushtet kur, procesi i ricertifikimit te punonjesve te sherbimit nuk ka perfunduar ende, dhe eshte ne proces per nje afat te pacaktuar kjo sipas informacionit te dhene nga Drejtoria e Policise se Shtetit, autoritetet kontraktore rekomandohen si me poshte vijon:

Ne rastet kur, ne dokumentat e tenderit do te kerkohet paraqitja e certifikatave te punonjesve te sherbimit, se bashku me kete kriter rekomandojme qe, te kerkohet edhe paraqitja e nje vertetimi te leshuar nga Drejtoria e Policise Vendore, i cili duhet te permbaje te dhena per listen emerore te punonjesve te sherbimit te certifikuar, dhe vlefshmerine e ketyre certifikatave – daten e certifikimit (daten e leshimit), si dhe afatin e vlefshmerise se kesaj certifikate.

Public Health Sector

Se fundmi, APP terheq vemendjen e autoriteteve kontraktore per te marre masat per zhvillimin e procedurave te prokurimit ne kohe, ne perputhje me legjislacionin ne fuqi, me qellim marrjen e ketij sherbimi, nepermjet procedurave konkurruese te parashikuara nga legjislacioni I prokurimit dhe shmangien e situatave qe cojne ne zbatimin e procedures se prokurimit "negocim pa shpallje paraprake te njoftimit te kontrates"

III.1.6. Komisioni i Prokurimit Publik gjykon se fryma dhe qellimi i ligjit është të nxisë pjesëmarrjen e operatorëve ekonomikë në procedurat e prokurimit, të sigurojë një trajtim të barabartë të tyre ndaj, kërkesat e vendosura nga autoriteti kontraktor duhet të jenë pikërisht në funksion të këtyre parimeve. Autoritetit kontraktor duhet të hartojë Dokumentat Standarte të Tenderit në përputhje me përcaktimet ligjore në fuqi dhe në mënyrë të tillë që të shprehin qartë kërkesat për cilësinë e shërbimeve dhe kushteve që do të përdoren, si dhe kërkesa të tjera, që lidhen ngushtë me natyrën dhe përbërësit e shërbimit objekt kontrate, pra duhet të përshkruajnë minimumin ose tërësinë e elementeve më të rëndësishme përbërëse, që garantojnë cilësinë e kërkuar. Referuar dispozitave ligjore në fuqi, Komisioni i Prokurimit Publik me qëllim thjeshtësimin dhe shmangien sa më shumë të jetë e mundur të vonesave në realizimin e kësaj procedure; reduktimin e numrit të ankesave; dhe shmangien e gabimeve në perlllogaritje të fondit

limit dhe/ose të kërkesave të tjera, të cilat cojnë në anulimin e procedurës; ka ardhur në ndihmë të autoriteve kontraktore dhe operatorëve ekonomikë me anë të Rekomandimit të përbashkët të APP (nr.prot.2511, datë 06.02.2017) dhe KPP (nr.prot.180, datë 06.02.2017) mbi mënyrën e zhvillimit të procedurës së prokurimit për marrjen e shërbimit privat të ruajtjes fizike.

III.1.7. Në këtë kuptim nga ana e Njesisë së Prokurimit të autoritetit kontraktor duhet të parashikohet përcaktimi i preventivit të shërbimit bazuar në zërat kryesorë që përbëjnë këtë shërbim sic janë: paga bazë, shtesat mbi pagë, sigurimet shoqërore e shëndetësore etj. bazuar në koston mujore për një roje në muaj (me zërat kryesorë të lartpërmendur), mbi bazën e të cilës llogariten shpenzimet për numrin e rojeve në një vëndroje për periudhën e caktuar, nëpërmjet një tablele ku të saktësohen të gjitha zërat e shpenzime të kërkuara.

Sa më sipër, pretendimi i ankimuesit “Dea Security” sh.p.k. qëndron.

III.2. Lidhur me pretendimin e operatorit ekonomik ankimues “Dea Security” sh.p.k., për modifikimin e dokumentave të tenderit lidhur me *numrin e rojeve, si të pamjaftueshëm dhe jo në përputhje me përcaktimet ligjore*, si dhe me pretendimin se *sipas numrit të ri të rojeve fondi limit del i pamjaftueshëm për përmbushjen e shpenzimeve të detyrueshme ligjore*, Komisioni i Prokurimit Publik, vëren se:

III.2.1. Në dokumentat e tenderit pjesa “Njoftimi i kontratës”, pika 2.2 dhe 2.3 “Përshkrimi i shkurtër i kontratës” është parashikuar si më poshtë:

1. *Fondi limit: 3.486.139,49 (tre milion e katerqind e tetedhjetë e gjashtë mijë e njeqind e tridhjetë e nente leke e dyzet e nente qindarka) pa TVSH*
2. *Burimi i financimit: Buxheti i Shtetit për vitin 2017*
3. *Objekti i kontratës/marrëveshje kuadër: Shërbimi me roje private SH.P.S.F – 2017*

2.3 *Kohëzgjatja e kontratës ose afati kohor për ekzekutimin: 01.08.2017 – 31.12.2017*

III.2.2. Në Shtojcën 8 “Specifikimet Teknike”, të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

[...]

Duhet te kete personel te licensuar, ne baze te akteve normative ne fuqi per (SHRSF), te cilet duhet te jene te pajisur me uniforme te rregullt, ku te jete e reklamuar dhe stema e shoqerise, te kene radio komunikimi, si dhe mjete mbrojtese per realizimin e sherbimit.

Te tjera,

Bashkelidhur ofertes çdo operator ekonomik krahas formularit te çmimit te ofertes dhe preventivit permbledhes do te paraqese dhe nje analize te hollesishme te kostos, shpenzime per paga, shtesa mbi page, sigurimet shoqerore si dhe elemente te tjere qe formojne çmimin e ofertes sipas model - preventivit te bashkelidhur DT-ve.

III.2.3. Në shtojcën 9 “Shërbimet dhe Grafiku i Ekzekutimit” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Shërbimi që kërkohet: SHRSF

Afatet e ekzekutimit: 01.08.2017 - 31.12.2017

III.2.4. Në shtojcën “Model Preventivi” të dokumentave të tenderit të procedurës së prokurimit rezulton se nga autoriteti kontraktor është përcaktuar:

Vendrojet :

- 1. Dera kryesore I (nje) vendroje me 3 (tre) turne, TI+TII+TIII, 24 ore*
- 2. Dera Repartit Obstetrike I (nje) vendroje me 3 (tre) turne, TI+TII+TIII, 24 ore*
- 3. Dera Repartit Gjinekologji I (nje) vendroje me 2 (dy) turne, TI+TII, 16 ore*
- 4. Dera Administrates I (nje) vendroje me 1 (nje) turn, me orar 08.00 - 16.00, 8 ore, per te cilen (Ditet e Shtunde, Diele, Festa do te jene Pushim)*

Per Vendrojet I+2+3, turnet jane si me poshte:

Turni i I-re, orari 06.00 - 14.00; Turni i II-te, orari 14.00 - 22.00; Turni i III-te, orari 22.00 - 06.00

- I- Preventivi I-re - Vendroja me 3 (tre) turne (4,86 punonjes/vendroje)*
- II- Preventivi II-te - Vendroja me 3 (tre) turne (4,86 punonjes/vendroje)*
- III- Preventivi III-te - Vendroja me 2 (tre) turne (3.24 punonjes/vendroje)*
- IV- Preventivi IV-te - Vendroja me 1 (nje) turn (1.08 punonjes/vendroje)*

III.2.5. Në Ligjin nr. 75/2014 “Për shërbimin privat të sigurisë fizike”, neni 18, gërma “g” është përcaktuar: *“Paga e punonjësit të rolit bazë të shërbimit të jetë minimalisht 50 përqind më e madhe se paga minimale e përcaktuar me vendim të Këshillit të Ministrave.*

III.2.6. Në VKM nr. 399, datë 03.05.2017 “Për përcaktimin e pagës minimale në shkallë vendi”, përcaktohet shprehimisht: *“Paga bazë minimale, mujore, për punonjësit, në shkallë vendi, që është e detyrueshme të zbatohet nga çdo person, juridik a fizik, vendas ose i huaj, të jetë 24.000 (njëzetë e katër mijë) lekë. Paga bazë minimale, mujore, jepet për 174 orë pune në muaj, të kryera gjatë kohës normale të punës. Paga bazë minimale orare të jetë 138 (njëqind e tridhjetë e tetë) lekë”.*

III.2.7. Në nenin 81 të “Kodit të Punës”, është parashikuar:

“1) Çdo orë pune e kryer nga ora 19.00 deri në 22.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 20 për qind.

2) Çdo orë pune e kryer midis intervalit 22.00 dhe 6.00 jep të drejtën e një shtese mbi pagë jo më pak se 50 për qind. ”.

Ndërsa neni 87 “Puna në ditën e diel ose në ditët e festave zyrtare” parashikon shprehimisht se:

“1. Puna e kryer në ditën e pushimit javor kompensohet me një shtesë page, jo më pak se 25 për qind, ose me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer plus një pushim shtesë, jo më pak se 25 për qind të kohëzgjatjes së kësaj pune.

2. Puna e kryer në ditët e festave zyrtare, kur ato bien ditë pune, kompensohet me një shtesë mbi pagë, jo më pak se 25 për qind dhe me një pushim të pagueshëm, të barabartë me kohëzgjatjen e punës së kryer në ditët e festave zyrtare..

Neni 92 i Kodit të Punës i ndryshuar parashikon shprehimisht se:

“1) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohen me kontratën kolektive ose me kontratën individuale të punës.

2) Kohëzgjatja e pushimeve vjetore është jo më pak se 4 javë kalendarike gjatë vitit të punës në vazhdim. Pushimet vjetore nuk përfshijnë ditët e festave zyrtare. Nëse festa zyrtare bie ditën e pushimit vjetor me pagesë, pushimi vjetor shtyhet.

3) Kur punëmarrësi nuk ka kryer një vit pune të plotë, kohëzgjatja e pushimeve vjetore të paguara përcaktohet në raport me kohëzgjatjen e marrëdhënieve të punës. Periudhat e paaftësisë së përkohshme në punë, konsiderohen si kohë pune”.

III.2.8. Kontributi i detyrueshëm për sigurimet shoqërore e shëndetësore i të punësuarit, nga pjesa e punëdhënësit, është 16,7%, referuar VKM-së nr.77, dt. 28.01.2015 *“Për kontributet e detyrueshme dhe përfitimet nga sistemi i sigurimeve shoqërore dhe sigurimi i kujdesit shëndetësor”.*

III.2.9. Në nenin 59, pika 2 të vendimit të Këshillit të Ministrave nr.914, datë 29.12.2014 *“Për miratimin e rregullave të prokurimit publik”, përcaktohet shprehimisht:*

“Në përlllogaritjen e vlerës limit të kontratës, autoriteti kontraktor duhet t’i referohet një ose më shumë alternativave të renditura si më poshtë:

- çmimet e botuara nga INSTAT-i, ose/dhe çmime të tjera zyrtare, të njohura nga institucionet përkatëse (si për shembull, nga organet tatimore a doganore, dhomat e tregtisë, në manuale etj); ose/dhe*
- çmimet e tregut; ose/dhe*
- çmimet e kontratave të mëparshme, të realizuara nga vetë apo nga autoritete të tjera kontraktore; ose/dhe*
- çmimet ndërkombëtare, të botuara.*

Autoriteti kontraktor, përpara nxjerrjes së urdhrat të prokurimit, duhet të dokumentojë përlllogaritjen e vlerës së kontratës.”

III.2.10. Në Udhëzimin e ri të Ministrisë të Brendshme Nr. 308, datë 22.05.2017 *“Për funksionimin e shërbimit privat të sigurisë fizike dhe qendrës së trajtimit privat të punonjësve të SHPSF-së”,* Kreu III, germa A, pika 2/b është parashikuar:

b) Numrin e vendrojave dhe numrin e punonjësve të shërbimit, duke llogaritur për 40 orë pune në javë ose koeficienti 1.66 për një punonjës shërbimi, si dhe skemat e ruajtjes së objektit.

III.2.11. Referuar numrit të rojeve të kërkuar nga autoriteti kontraktor për kryerjen e shërbimit në përputhje me numrin e vendrojave, model preventivit parashikuar nga autoriteti kontraktor mbi kohëzgjatjen e kryerjes së shërbimit (turneve) dhe ditët në të cilin kërkohet kryerja e shërbimit për të gjithë periudhën (5 muaj), nga llogaritja e kryer, Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se numri i rojeve i përcaktuar nga autoriteti kontraktor për vendrojet me 3 (tre) dhe 2 (dy) turne nuk është në përputhje me Udhëzimin 308, datë 22.05.2017 të Ministrisë të Brendshme dhe rrjedhimisht nuk është i mjaftueshëm për kryerjen e shërbimit. Ndërsa në lidhje me numrin e rojeve për vendorjen me 1 (një) turn, ku nga ana e autoritetit përcaktohen ditët e shtuna dhe të diela pushim, ky numër është i mjaftueshëm, pasi në rastin kur është kërkuar shërbimi në vendrojet me 3 (tre)

dhe 2 (dy) turne nga ana e autoritetit kontraktor kërkohet kryerja e shërbimit me roje pa ndërprerje dhe në këtë kuptim, referuar Udhëzimin të Ministrisë të Brendshme si më lart cituar, koeficienti i rojeve është 1.66 dhe për pasojë numri i rojeve duhet të jetë 4.98 për vendroje me 3 (tre) turne dhe 3.32 roje për vendroje me 2 (dy) turne.

Vlen të theksohet se në informacionin e dorëzuar nga ana e autoritetit kontraktor nuk është dhënë asnjë sqarim lidhur me pretendimin e ngritur nga ankimuesi, si dhe nuk është paraqitur asnjë procesverbal i mbajtur nga njësia e prokurimit për mënyrën e llogaritjes së numrit të rojeve për këto vendroje, në kundërshtim me VKM nr.914, datë 29.12.2014, neni 61, sipas të cilit *dokumentat e tenderit hartohen nga njësia e prokurimit në përputhje me këto rregulla dhe legjislacionin në fuqi. [...] Në çdo rast, hartimi i kriterëve për kualifikim dhe specifikimet teknike duhet të argumentohen dhe të dokumentohen në një procesverbal të mbajtur nga personat e ngarkuar për përgatitjen e tyre.*

III.2.12. Gjithashtu, në lidhje me pretendimin e palës ankimuese mbi ndryshimin e fondit limit për procedurën e prokurimit objekt ankimi, sa më sipër Komisioni i Prokurimit Publik konstaton se fondi limit i parashikuar nga autoriteti kontraktor është i mjaftueshëm për kryerjen e shërbimit edhe duke marrë parasysh ndryshimet e konstatuara më sipër në lidhje me numrin e rojeve.

Pra, pretendimi i operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k. qëndron në lidhje me ndryshimin e numrit të rojeve për vendrojet me 3 (tre) dhe 2 (dy) turne dhe nuk qëndron pretendimi i operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k. për ndryshimin e numrit të rojeve për vendrojen me 1 (një) dhe për ndryshimin e fondit limit.

Sa më sipër, pretendimet e operatorit ekonomik “Dea Security” sh.p.k. qëndrojnë pjesërisht.

Përsa më sipër, në mbështetje të nenit 19/1 dhe vijues, të ligjit nr. 9643, datë 20.11.2006 “Për Prokurimin Publik”, i ndryshuar, nenit 28 të VKM-së nr.184, datë 17.03.2010 “Për miratimin e rregullores “Për organizimin dhe funksionimin e Komisionit të Prokurimit Publik”, i ndryshuar, Komisioni i Prokurimit Publik, njëzëri,

Vendos

1. Të pranojë pjesërisht ankesën e paraqitur nga operatori ekonomik “Dea Security” sh.p.k. për procedurën e prokurimit “*Kërkesë për propozim*”, me objekt: “*Shërbim me roje private SH.P.S.F 2017*”, me nr. REF-19243-07-03-2017, me fond limit 3.486.139,49 lekë (pa TVSH), parashikuar për t’u zhvilluar në datën 14.07.2017, nga autoriteti kontraktor, Spitali Universitar Obstetrik – Gjinekologjik “Mbretëresha Geraldinë”.
2. Autoriteti kontraktor të kryejë modifikimet përkatëse në përputhje me arsyetimet dhe konstatimet e mësipërme të Komisionit të Prokurimit Publik.
3. Autoriteti kontraktor të njoftojë Komisionin e Prokurimit Publik mbi zbatimin e këtij vendimi brenda 10 ditëve, në përputhje me parashikimet e Vendimit nr. 482 datë

05.07.2017 të Këshillit të Ministrave “Për Pezullimin e Përkohshëm të Procedurave të Prokurimit, për Vitin 2017”.

4. Ngarkohet zyra e financës që të bëjë kthimin e tarifës financiare të paguar nga operatori ekonomik ankimues “Dea Security” sh.p.k.
5. Kopje e këtij vendimi i dërgohet për njoftim Agjencisë së Prokurimit Publik.

Ky vendim hyn në fuqi menjëherë.

Nr. 1282 Protokoli,
Datë 17.07.2017

KOMISIONI I PROKURIMIT PUBLIK

Anëtar
Hektor Balluku

Anëtar
Kleves Janku

